Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Swiss Agency for Development and Cooperation SDC

UNITED NATIONS ALBANIA

UNDP

Bashkia Devoll

Programi 5- Vjeçar i Strehimit Social 2024-2029
Plani Lokal i Strehimit Social



MetroPOLIS Associated, Architecture & Planning

Co-PLAN INSTITUTE FOR HABITAT DEVELOPMENT

Leave No One Behind

Ky dokument është realizuar nga Bashkia Devoll me mbështetjen e UNDP, programi "Leave no one behind/ Askush të mos mbetet pas Faza 2". Programi 5-vjeçar i strehimit është hartuar në kuadër të projektit "Support Municipalities in Albania to Design the 5-year Social Housing Municipal Plans", zbatuar nga MetroPOLIS dhe Co-PLAN, Instituti për Zhvillimin e Habitatit

Në kuadër të këtij procesi, u mbështetën nëntë bashki pilot, përkatësisht Kolonjë, Devoll, Devoll, Librazhd, Maliq, Pogradec, Lushnje, Berat dhe Elbasan për të hartuar programet e tyre 5-vjecare të strehimit (plane vendore të strehimit social), referuar ligjit 22/2018 'Për strehimin social'.

Grupi i Punës nga MetroPOLIS & Co-PLAN: **Ledio Allkja, Kejt Dhrami, Merita Toska, Imeldi Sokoli, Rea Muka, Fiona Imami**

Grupi i Punës nga Bashkia Devoll: **Zerina Sinani, Marilda Bejleri, Linda Laçi, Aurela Furrxhi, Tatjana Spaho, Valbona Beshi, Esjona Meka, Sofika Papa, Eni Kutrolli, Gjergji Liço, Erjona Shaholli, Besmir Lata, Theodoraq Kuke, Manjola Hanelli, dhe Matilda Hoxha.**

Mbështetur nga **UNDP, "Leave no on behind"**

Tabela e Përmbajtjes

HYRJE 4
1.1 QËLLIMI I PLANIT 5
1.2 METODOLOGJIA E PËRDORUR 5
1.3 STRUKTURA E DOKUMENTIT 6
1.4 PROFILI I BASHKISË 6
VLERËSIM I THELLUAR I SITUATËS EKZISTUESE 8
2.1 ANALIZA E TRENDEVE DEMOGRAFIKE E SOCIAL-EKONOMIKE TË POPULLSISË 8
2.2 ANALIZA E GRUPEVE VULNERABËL 10
2.3 SHPËRNDARJA E SHËRBIMEVE 12
2.4 ANALIZA E TREGUT TË BANESAVE NË BASHKI 14
2.5 ANALIZA E NEVOJAVE PËR STREHIM SOCIAL DHE TË PËRBALLUESHËM (SHTOJCA 3&4) 16
2.6 Analiza e Trojeve Potenciale për ndërtim 18
VIZIONI, OBJEKTIVAT DHE PROGRAMET 19
3.1 VIZIONI DHE SFIDAT KRYESORE TË BASHKISË 19
3.2 QËLLIMET DHE PARIMET 20
3.3 OBJEKTIVAT AFATGJATË DHE PROGRAMET E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN 5-VJEÇARE 20
3.4 Programi i detajuar 24
MONITORIMI DHE ZBATIMI 27
4.1 Risqet e zbatimit 29
Referencat 32
Anekset 32
Aneksi 1 Analiza Plotësuese e Strehimit Social Bashkia Devoll 32
Aneksi 2 Minuta Takime Bashkia Devoll 32

Lista e Tabelave

Tabela 1. Të dhënat për Bashkinë Devoll 6
Tabela 2.Trendi i popullsisë 2000-2020 9
Tabela 3. Numri i pjestarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Devoll 12
Tabela 4. Problematikat kryesore të komunitetit Rom dhe Egjiptian në bashkinë Devoll 12
Tabela 5. Stoku i Banesave bashkia Devoll 15
Tabela 6. Vlera e banesave sipas cimimit në Bashkinë Devoll 15
Tabela 7. Numri i aplikanteve dhe përfituesve sipas programit të strehimit social 16
Tabela 8. Programi i detajuar 24
Tabela 9. Monitorimi i situatës së strehimit në Bashki 28

Lista e Figurave

Figura 1. Shpërndarja e popullsisë sipas NjA-ve 8
Figura 2. Struktura sipas grup - moshave e popullsisë (viti 2020) 10
Figura 3. Familje përfituese të Ndihmës ekonomike dhe Karakteristikat e familjeve përfituese 10
Figura 4. Të dhëna krahasuese mbi punëkërkuesit e papunë sipas gjinisë 10
Figura 5. Persona me aftësi të kufizuara sipas njësive administrative 11
Figura 6. Analiza e periferialitetit 13
Figura 7. Mosha e ndërtimeve me qëllime banimi 14
Figura 8. Zonat potenciale për strehim social 18



1

HYRJE

Një ndër detyrat kryesore të Bashkisë Devoll për Drejtorinë e Shërbimeve Sociale, Shëndetësisë dhe Strehimit është hartimi i planit 5-vjeçar të strehimit social në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi. Hartimi i këtij programi shërben si kusht kryesor për përfitimin e fondeve nga Qeveria Qendrore në lidhje me gjashtë programet aktualisht të përcaktuara në ligjin për strehimin social. Gjithashtu, programi i mundëson Bashkisë Devoll identifikimin e nevojave specifike për strehim social dhe planifikimin buxhetor për to. Nga ana tjetër, ministria përgjegjëse për strehimin (aktualisht Ministria e Ekonomisë Kulturës dhe Inovacionit) ka mundësinë të vlerësojë dhe rishikojë periodikisht Strategjinë Kombëtare të Strehimit duke u bazuar në të dhëna lokale dhe ecurinë e strehimit social në nivel vendor. Përmbajtja e planit bazohet në udhëzimet e ligjit nr. 22/2018, 'Për Strehimin Social', neni 68, programi lokal 5-vjeçar i strehimit.

Plani i shtjelluar në vijim të këtij dokumenti trajton çështjet e programit 5-vjeçar sipas ligjit, por ndërkohë vendos edhe një kornizë strategjike në lidhje me strehimin social. Plani përmban një vizion dhe objektiva të zbërthyera në programin konkret me aktivitete. Për këtë arsye, si dhe për të shmangur çdo ngatërrim të mundshëm me gjashtë programet e strehimit social të parashikuara nga ligji, në këtë dokument përdoret edhe emërtimi 'Plan' për të nënkuptuar 'Programi 5-vjeçar i strehimit social'.

1.1 QËLLIMI I PLANIT

Qëllimi i hartimit të programit 5-vjeçar të strehimit për Bashkinë Devoll është njohja dhe identifikimi i grupeve vulnerabël dhe nevoja e tyre për strehim dhe propozimi i alternativave afatmesme për sigurimin e strehimit të përballueshëm, sipas programeve të legjislacionit përkatës. Bazuar në nenin 68 të ligjit 22/2018 'Për strehimin social', strukturat përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore hartojnë programe 5-vjeçare strehimi social për popullsinë nën juridiksionin e tyre, të cilat miratohen nga këshilli bashkiak i njësisë.

Qëllimi i planit detajohet si më poshtë:

- vlerësimi i kontekstit dhe nevojave për strehimi social për grupet sipas ligjit dhe veçanërisht ato më të cenuara në territorin e bashkisë;
- vlerësim i kapaciteteve në nivel bashkie qofshin ato njerëzore, teknike, financiare dhe organizative për të adresuar shërbime/nevoja të tilla;
- propozime konkrete dhe vlerësime të buxhetit për zbatimin e tyre, sipas nevojave për strehim dhe instrumenteve ligjore e financiare.

1.2 METODOLOGJIA E PËRDORUR

Metodologjia për hartimin e Planit Lokal të Strehimit u bazua si në proces por edhe në përmbajtje fillimisht duke mbledhur, organizuar dhe sintetizuar informacionin në dispozicion, nëpërmjet të cilës u krijua një ide mbi kontekstin e Strehimit Social në vend (nëpërmjet Pyetsorit) dhe situatës në nivel lokal (nëpërmjet intervistave; mbledhjes së informacioneve dhe të dhënave me përfaqësues nga Bashkia). Rishikimi i dokumenteve dhe strategjive të planifikimit në nivel kombëtar dhe sidomos në nivel lokal ishte një proces i rëndësishëm prej të cilit u evidentua rëndësia që i është dhënë këtij sektori në këto dokumenta si edhe nevoja e bashkisë për këtë plan. Për të mbështetur këtë plan dhe këtë nevojë fazat pasuese u lidhën me analiza më të detajuara parashikuar kjo edhe në nenin 68 të Ligjit të Strehimit. Këto analiza patën në fokus grupet vulnerabël që ndodhen në territorin e Bashkisë Devoll; nevojën për strehim; numrin e familjeve që do të përfitojnë banesa me kosto të ulët; analiza mbi rreziqet natyrore për furnizimin me banesa; burimet e financimit; lidhjet e këtij programi me programe të tjera të njësisë së vetëqeverisjes vendore; masën e subvencionimeve nga buxheti i shtetit dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe gjithashtu një analizë të përgjithshme për profilin social-ekonomik të bashkisë.

Pas mbledhjes së informacioneve dhe kryerjes së analizave u punua me përgatitjen e dokumentit "draft" të Planit Lokal të Strehimit dhe kaloi në fazë konsultimi me palët e interesuara në nivel lokal.

Faza e fundit mbyllja e raportit final nga konsultimi me palët e interesuara lokale dhe MEFE dhe PNUD dhe përgatitja e këtij Plani Lokal për Bashkinë Devoll.

1.3 STRUKTURA E DOKUMENTIT

Plani është strukturuar në 3 pjesë kryesore:

1. Përshkrimi i përgjithshëm mbi Bashkinë dhe të dhëna bazë;
2. Analiza të thelluara të situates ekzistuese: tendenca demografike e social-ekonomike; grupet e cenuara (vulnerabël); tregu i i banesave në Devoll; nevojat për strehim social dhe të përballueshëm; troje potenciale për ndërtim për qëllime strehimin social në bashki; potenciale për aplikimin e instrumenteve financiare për zhvillimin e tokës, sipas legjislacionit për planifikimin e territorit dhe ligjit nr. 22/2018 'Për strehimin social'.
3. Paraqitja e Vizionit, Objektivave dhe Programeve/ Projekteve që i përshtaten bashkisë si rezultat i analizave, përfshirë edhe udhëzime për monitorimin dhe zbatimin e planit.

1.4 PROFILI I BASHKISË

Bashkia e re e Devollit, pas reformës Territoriale Administrative është e përbërë nga pesë njësi administrative: Bilisht, Qendër Bilisht, Hoçisht, Progër dhe Miras. Kufizohet në veri me Bashkinë Puctec, në jug me Bashkinë Kolonjë si dhe në në perendim me bashkinë Korçë dhe Maliq. Bashkia ka një sipërfaqe prej 453.27km² dhe një popullsi prej 26716 banorë sipas Censusit 2011 dhe 42388 banorë sipas Regjistrit te Gjendjes Civile përqëndrimi më i lartë i popullsisë është në Qytetin e Bashkisë Devoll atë të Bilishtit.

Qëndra kryesore e banimit është Bilishti ndërkohë pjesa tjetër e territorit paraqet një përqendrim të ulët, sidomos në zonat malore. Pavarësisht se si numër popullsie kjo qëndër e madhe banimi cilësohet si zone banimi urbane (INSTAT, 2014) në tërësi kjo bashki ka karakter rural, me sipërfaqe te konsiderueshme natyrore e bujqësore. Si e tillë paraqet një sfidë për të hartuar programe që lidhen me strehimin social për shkak të disavantazheve që paraqiten nga terreni në aspektin e largësisë për të marrë shërbime të caktuara. Një tjetër problematikë e zonave të thella rurale është varfëria dhe papunësinë. Këto disavantazhe i bëjnë Programet e Strehimit Social në Devoll një sfidë por jo të parealizueshme pasi përtej përfitimit që vjen nga strehimi si shërbim, mundësia për të mbajtur popullsinë në komunitet e tyre mund të minimzojë edhe një nga problemet që shoqëria shqiptare po has, atë të migrimit. Këto sfida dhe mundësi theksojnë rëndësinë që ka hartimi i programeve sociale që mbështeten në një njohje të mirë të situatës lokale.

Tabela 1. Të dhënat për Bashkinë Devoll

Njësitë administrative	Vendbanim	Popullsia rezidente 2016 (banorë)	Sipërfaqe (km²)	Densiteti 2016 (banorë/km²)
Bilisht	Qyteti Bilisht	6250	12.37	505.08
Qender Bilisht	Fshatrat; Bitinckë, Tren, Buzliqen, Vërnik, Vishocicë, Kuç, Poloskë, Kapshticë, Trestenik, Kurilë	5440	95.86	56.75
Hoçisht	Fshatrat; Hoçisht, Grace, Baban, Stropan, Eçmenik, Përparimaj, Grapsh, Çipan, Borsh, Bradvicë	4461	86.64	51.49
Progër	Fshatrat; Progër, Mançurisht, Cangonj, Pilur, Vranisht, Bickë, Rakickë, Shyec	3988	90.74	43.95

Miras	Fshatrat; Miras, Vidohovë, Arrëz, Çetë, Qytezë, Sinicë, Nikolicë, Menkulas, Ponçarë, Braçanj, Koshnicë, Dobranj, Fitore, Ziçisht, Gjyres, Sul	4461	114.41	38.99
Bashkia Devoll		26716	790.41	33.8

Burimi: Porta Vendore, Bashkia Devoll, PPV Devoll 2019

Situata e Strehimit në bashki lidhet ngushtë me ndryshimin e popullsisë dhe kryesisht nevojës për përmirësime të banesave. Në Bashkinë e Devollit popullsia paraqet një rrenjë të madhe të 5 njësitë administrative që e përbëjnë atë. Njësitë administrative të cilat paraqesin rrënjën më të madhe tek numri i banoreve gjatë viteve të fundit janë ato të Hoçishtit, Progërit dhe Mirasit. Faktorët kryesorë që lidhen me rënien e popullsisë janë si ekonomike ashtu edhe sociale, si për shembull mungesa e shërbimeve publike dhe investimeve, papunësia e lartë, cilësia e dobët e rrjetit rrugor që lidh këto njësi administrative me qendrën e Bashkisë ose me qytet të tjera përreth si dhe relievi i theksuar malor. Këto tendenca lidhen edhe me fenomenin e migrimit të brendshëm nga zonat rurale të largëta drejt zonave urbane. Si rezultat edhe nevoja për strehim ka ndryshuar. Pavarsisht uljes së vazhdueshme të popullsisë në bashki kemi rritje te kërkesës për stehim sepse kushtet e jetesës bëjnë që shumë familje ta kenë të papërballueshme pasjen e nje shtepie dhe sigurimin e të ardhurave për banim. Në këtë rast kemi edhe shume ndërtime te pashfrytëzuara dhe boshe si pasoje e emigrimit te brendshëm. Rritja e kërkesës për strehim social është rritur edhe për shkak të kompleksitetit të strukturës sociale të familjeve dhe grupeve në nevojë, po aq edhe me tregun jo të përballueshëm nga popullsia. Për të përballuar sfidën e strehimit social nevojitet bashkëpunimi mes aktorëvë publikë e privatë dhe midis nivelit vendor e qendror të qeverisjes.

Në zonat urbane të Bilishtit, zbatimi i programeve të strehimit social është thelbësor për zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit, sepse ul pabarazitë dhe mundëson trajtimin e grupeve vulnerabël me kushte më të mira strukturore, shëndetësore dhe sanitare të banesave. Ndërkohë, në zonat rurale disa nga sfidat që mund të hasin këto njësi administrative janë:


- Kalimi i të drejtave të pronësisë, që kërkojnë ndërhyrjen e pushtetit qendror.
- Cilësi jo e mirë strukturore e banesave, të cila kanë të ngjarë të shemben ose të jenë në rrezik shembjeje.
- Kushtet shëndetësore dhe sanitare të banesave janë më të ulëta.
- Aksesi në shërbimeve publike dhe sociale është më i ulët.

Nga ana tjetër zonat rurale mund të kenë në dispozicion truall të lirë ndërtimi dhe sipërfaqja mesatare e tokës së lirë për njësitë administrative rurale është 77,000 m2; ndërkohë që për njësitë administrative). urbane është 8,366 m2 (Ministria e Zhvillimit Urban, MZHU, 2016



2

VLERËSIM I THELLUAR I SITUATËS EKZISTUESE



Burimi: Raporti i vlerësimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror (Gusht 2020)

Sipas të dhënave zyrtare të regjistrimit të vitit 2011, Bashkia e Devollit ka një popullsi prej 26.716 banorë, që përfaqëson 11.9% të popullsisë së përgjithshme të Qarkut Korçë (220,900 banorë) dhe 0.95% të popullsisë së përgjithshme të Shqipërisë (2,800,138 banorë). Me një klasifikim të ngjashëm evidentohet edhe numri i banesave. Kështu, shumica e tyre regjistrohen në njësitë administrative Qendër Bilisht, Bilisht dhe Miras dhe më pak në Njësine administrative të Progrit dhe Hoçisht.

Referuar regjistrimit të Censusit 2011 për popullsine e Bashkisë sipas gjinisë popullsia e meshkujve dhe femrave nuk kanë ndryshim të madh midis tyre pasi përqindja e meshkujve në territorin e Bashkisë është rreth 50.12% ndërsa popullsia e femrave është 49.88%.

Në Bashkinë e Devollit popullsia paraqet një rënie të madhe të 5 njësitë administrative që e përbëjnë atë. Njësitë administrative te cilat paraqesin rrënjen më të madhe tek numri i banoreve gjatë njëzet e dy viteve të fundit janë ato të Hoçishtit, Progërit dhe Mirasit, Faktorët kryesorë që lidhen me rënien e popullsisë janë si ekonomike ashtu edhe sociale, si për shembull mungesa e shërbimeve publike dhe investimeve, papunësia e lartë, cilësia e dobët e rrjetit rrugor që lidh këto njësi administrative me qendrën e Bashkisë ose me qytet të tjera përreth si dhe relievi i theksuar malor. Ndryshim të konsiderueshëm në pikëpamje të banesave, si rrjedhojë e rritjes së numrit të ndërtesave me shumë kate, kryesisht në qytete. Nga analiza e ndërtesave për banim sipas llojit tek njësia administrative e Bilishtit shenohet numëri më i madh i apartamenteve pasi ka një përqindje më të lartë krahesuar me njësitë e tjera administrative të Bashkisë, prej 3.95% (INSTAT, 2011).

Tabela 2.Trendi i popullsisë 2000-2020


Bashkia Devoll	Ndryshim I Popullsisë 1989-2001	Ndryshim I popullsisë 2001-2011
Bilisht	-1,59	-16,08
Qendër Bilisht	-26,97	-16,08
Hocisht	-37,57	-23,99
Progër	-37,71	-23,72
Miras	-41,67	-29,79

Burimi: PPV & Raporti i vlerësimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror (Gusht 2020)

Në vitin 2011, raporti i varësisë së të rinjve (raporti i personave në moshë 0-14 vjeç ndaj popullsisë në moshë pune 15-64 vjeç) ka shënuar një përqindje prej 27,2%. Raporti i varësisë së të moshuarve (raporti i personave në moshë 65+ vjeç ndaj popullsisë në moshë pune 15- 64 vjeç) ka një përqindje prej 25.4%

gjatë së njëjtës periudhë. Gjithashtu gjatë kësaj periudhe është regjistruar se popullsia e femrave në grupmoshat 0-14 vjeç është 49.07% e popullsisë të grupmoshës 0-14 vjeç ndërsa popullsia e meshkujve është 50.93%.

Figura 2. Struktura sipas grup - moshave e popullsisë (viti 2020)




Burimi: Raporti i vlerësimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror (Gusht 2020)

2.2 ANALIZA E GRUPEVE VULNERABËL

Të ardhurat e banorëve të bashkisë të Devollit bazohen përveç punësimit edhe në të gjitha llojet e pensioneve dhe në para të cilat ju dërgohen nga pjestarë të familjes qe janë të punësuar jashtë shtetit. Përqindja e popullsisë e cila ka si burmin të ardhurash pensionë është rreth 38.6%, ndërsa nga para të ardhura nga jashtë shtetit rreth 9%. Sipas regjistrimit të INSTAT, 2011, për ndihmën sociale në Bashkinë e Devollit, 6.1% e popullsisë të saj përfitojnë këtë asistence. Me specifikisht përqindja me e madhe e ndihmës sociale dhe përfitimeve janë shpërndarë tek Njësitë Administrative të Bilisht, Progër dhe Hoçisht. Njësitë Administrative të Mirasit dhe Qendër Bilishtit janë ato të cilat kanë përgjindjen më të vogel nga të ardhurat të cilat kanë prejardhje nga ndihmat sociale.


Figura 3. Familje përfituese të Ndihmës ekonomike dhe Karakteristikat e familjeve përfituese



Burimi: Raporti i vlerësimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror (Gusht 2020

Sa i përket të dhenave të papunësisë në bashkinë Devoll në të gjitha NJA-të papunësia e përgjithshme dhe sipas gjinisë është më e ulët se në rang kombëtarë ndërsa papunesia tek të rinjtë vetëm në qytetin e Bilishtit është më e lartë kundrejtë rangut kombëtarë.


Figura 4. Të dhëna krahasuese mbi punëkërkuesit e papunë sipas gjinisë



Burimi: Përpunuar nga autorët me të dhënat nga Raporti i vlerësimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror (Gusht 2020)

Personat me aftësi të kufizuar jane një ndër indikatoret kryesor të përcaktimit te grupeve vulnerabel ne bashki sepse si te të tille Përsa i përket Bashkisë të Devollit në lidhje me popullsinë me aftësi të kufizuara përqindjet me të mëdha shënohen tek kategoritë e kufizimit të ecjes, të shikimit, të dëgjimit dhe kujtesës duke përfshirë 3.5%, 2.1% dhe 1.9% respektivisht të popullsisë të regjistruar me aftësi të kufizuar. Gjithsej në Bashki 6.4 % e popullsisë 15 vjeç e lart ka të paktën një aftësi të kufizuar (Tabela 5.10.1). Duke analizuar popullsinë me aftësi të kufizuara sipas njësive administrative të Bashkisë të Devollit konkludohet se në të gjitha njësitë administrative popullsia me aftësi të kufizuara në ecje (28% e popullsinë me aftësi të kufizuara) është ajo që dominon, dhe ne vijim janë kategoritë e popullsisë me aftësi të kufizuar në shikim (17%) dhe në kujtesë (16%). Gjithashtu tek Njësitë Administrative të Bilisht, Qëndër Bilisht dhe Miras janë regjishtuar pjesa me e madhe e popullsisë me aftësi të kufizuara brenda territorit të Bashkisë. Për Persona me Aftësi të Kufizuar nuk ka qendra përkujdesjeje, infrastrukturë të posaçme apo transport publik të dedikuar.

Figura 5. Persona me aftësi të kufizuara sipas njësive administrative



Burimi: Përpunuar nga autorët me të dhënat nga Raporti i vlerësimit të nevojave për shërbime të kujdesit shoqëror (Gusht 2020)

Në analizën e grupeve vulnerabël përfshihen gjithmonë analizat socio-ekonomike të grupeve etnike të Romëve dhe Egjiptianëve si një ndër grupimet më të mëdha që i drejtohen bashkive për sherbime sociale. Në territorin e Bashkisë Devoll numerohen rreth 344 individë të komunitetit Rom dhe 100 individë të komunitetit Egjiptin ku pjesa me e madhe e tyre ndodhet në qytetin e Bilishtit por po ashtu edhe Fshatra si Bitincka, Treni dhe Progri. Nga anketat e zhvilluara në terren ndër problematikat kryesore qe rendit ky komunitet janë edhe kushtet e këqija të banimit të cilat zënë rreth 26.2% të përgjigjeve. Papunësia është problem kryesor që ka komuniteti në territor sepse mungojnë politika të tilla qe afrojnë komunitet Rome dhe Egjiptiane me bizneset në zonë në mënyrë që të kenë kushte më të mira jetese.

Tabela 3. Numri i pjestarëve të komunitetit Rom dhe Egjiptian në Bashkinë Devoll

Romë	Numër	Përqindje
Bilisht	274	79.7
Bitinckë	49	14.2
Proger	2	0.6
Tren	19	5.5
Totali	344	100

Burimi: Bashkia Devoll dhe MetroPolis 2023

Tabela 4. Problematikat kryesore të komunitetit Rom dhe Egjiptian në bashkinë Devoll

Problemet ryesore	Totali	Romë	Egjiptianë
Mungesa e shqimit	8.4	8.1	9.1
Papunësia	43.9	48.6	33.3
Kushtet e këqija të banimit	26.2	23	33.3
Mungesa e veshmbathjeve	5.6	5.4	6.1
Problemet shëndetsore	11.2	12.2	9.1
Infrastruktura e keqe	4.7	2.7	9.1
Total	100	100	100

Burimi: Bashkia Devoll dhe MetroPolis 2023

2.3 SHPËRNDARJA E SHËRBIMEVE

Shërbimet publike u referohen funksioneve publike që i shërbejnë administratës, arsimit, shëndetit dhe kujdesit, kulturës dhe sportit. Nga studimet e kryera dhe në bazë të arkivave të Bashkisë dhe korrepondencës me Shërbimet kompetente, u regjistruan të dhëna për infrastrukturat ekzistuese. Shërbimet më të shumta identifikohen në qytetin e Bilishtit, që është edhe qendra e Bashkisë.

Në lidhje me administratën, të gjitha ndërtesat e administratës ndodhen në qytetin e Bilishtit, me përjashtim të ndërtesave të dikurshme ku shumica e tyre jane jashtë funksioni.

Infrastrukturat e arsimit në bazë të të dhënave të Bashkisë. Vërehet një numër i madhe i njësive arsimore në arsimin bazë (2/3 e vendbanimeve kanë shkolla 9-vjecare ose fillore) të cilat kanë një numër shumë të vogël nxënësish, që ka sjellë si rezultat një nivel të pakënaqshëm arsimi, kryesisht në fshatrat më të vegjël dhe të largët: infrastruktura që mungojnë (psh. laboratore, pajisje), nxënës me nivel të ndryshëm në klasa të përbashkëta (klase kolektive), etj.

Kopshtet funksionojnë në çdo njësi administrative. Përsa i përket arsimit të mesëm, gjithashtu, funksionon një njësi në çdo njësi administrative përveç Qëndër Bilisht, nxënësit e të cilës shkojnë në


Gjimnazin "Fuat Babani" në Bilisht, i cili është një njësi shumë e madhe. Nuk funksionon asnjë shkolle private.

Shërbimi primar shëndetsor në Bashki sigurohet nga 56 infermiere dhe 15 mjekë familjarë: 4 në qytetin e Bilishtit, 4 në Miras, 3 në Qendër Bilisht, 2 në Hoçisht dhe 2 në Progër. Në çdo ambulancë ka një infermiere, ndërsa në përgjegjësinë e një mjeku janë më shumë se një njësi. Niveli i shërbimit është i kënaqshëm, por nuk mungojnë problemet e vecanta. Këto kanë të bëjnë me mungesën e stafit dhe të pajisjeve mjekësore (p.sh. në spitalin e Bilishtit) dhe infrastrukturës së ndërtimit të degraduar apo edhe të papërshtatshme (p.sh. në Vranisht) për shkak të mirëmbajtjes joadekuate ose mungesës së pajisjeve (p.sh. ngrohjes). Gjithashtu shumë shpesh njësitë shëndetësore bashkëjetojnë me njësitë e arsimimit, brenda së njëjtës ndërtesë ose truall, gjë që shkakton konflikte në dy këto funksione të papajtueshme midis tyre. Për shërbime më të specializuara, Bashkia mbulohet nga spitali i Korçës, që ndodhet në një distancë të shkurtër nga Bilishti.

Infrastrukturë Shëndetësore në bazë të të dhënave të bashkisë dhe nga puna në terren rezulton gjëndja e mëposhtme përsa i përket gjëndjes së **infrastrukturës së shëndetit**:

Në shumicën e fshatrave të Bashkisë ka njësi shëndetësore që mbulojnë të gjithë popullsinë. Në qytet funksionon një spital, në selitë e njesive administrative operojnë qendra shëndetësore dhe në një seri fshatrash, në ato më të mëdhetë, operojnë ambulanca, sipas tabelës së mëposhtme.

Figura 6. Analiza e periferialitetit



Burimi: MetroPOLIS 2023


Analiza e periferialitetit mat nivelin e aksesueshmërisë së shërbimeve publike të ndryshme kundrejt vendbanimeve dhe territoreve. Në rastin e mësipërm është paraqitur aksesi ndaj institucioneve të arsimit në bazë të distancës në raport me vendbanimet. Nga kjo situatë vërehet se disa vendbanime dhe territore në pjesën jug-perendimore të NjA Miras dhe në pjesën lindore të NjA Bilisht Qendër nuk aksesohen nga asnjë lloj shërbimi arsimor gjë që i bën territore periferike në bazë të aksesueshmerisë.

2.4 ANALIZA E TREGUT TË BANESAVE NË BASHKI

Një përmbledhje e përgjithshme sipas Censusit 2011 për situatën e Strehimit në Bashkinë Devoll është pasqyruar në tabelën më poshtë sipas Analizës nga dokumenti i PPV.

Në bazë të analizës së moshës së ndërtimeve për qellime banimi vërehet se në bashkinë Devoll rreth 40% e banesave nuk dihen se kur jane ndërtuar. Në përgjithësi kontigjenti I banesave është ndërtuar në të kaluarën pra në periudhën para viteve 90 ndërkohë një sasi realtivisht e ulët në krahasim me mesataret kombëtare është ndërtuar në dy periudhat e tjera 1991-2001 dhe pas viteve 2001. Kjo analizë tregon se struktura e qytetit përgjithsisht nuk ka ndërruar dhe kemi një sasi deri diku të lartë të ndërtimeve me moshë të madhe që do të thotë që ky kontigjent ndërtimesh ka nevojë për rinovime dhe rehabilitime të qënësishme.

Figura 7. Mosha e ndërtimeve me qëllime banimi



Burimi: Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Devoll

Sipas të dhënave që dalin nga cilësia e kushteve të banimit vihet re se në bashkinë e Devollit përgjithësisht indikatorët janë pozitivë në lidhje me numrin e dhomave për familje si dhe sipërfaqen e banimit për banorë. Gjithashtu një masë e madhe e banesave jane të pa banuara gjë që tregon se ka mundësi për aplikimin e programit të pronarit social por që aktualisht këto banoërë janë të painteresuar për të hyrë në negociata të tilla me bashkinë për të pranuar qeradhënës nga shtresat e marxhinalizuara në bashki.

Tabela 5. Stoku i Banesave bashkia Devoll

Popullsia	26716 banorë
Familja mesatare	3.7 banorë/familje
Familje	7 220 familje
Dhoma/familje	3.3 dhoma/familje
Dhoma/banor	0.9 dhoma/banor
Sipërfaqe mesatare/ njësi banimi	54.76 m²/njësi
Sipërfaqe njësish banimi (e jetuar)	438307 m²
Sipërfaqe banimi/banor	14.8 m²/banor
Njësi banimi me qera	0.12%
Ndërtesa banimi ndërtuar para '91	43.4%
Njësi banimi të pabanuara	18.9%

Burimi: Plani i Përgjithshëm Vendor Bashkia Devoll

Një faktor mjaft i rëndësishëm për përballueshmërinë e strehimit në banesa është vlerësimi tregut të banesave në bashki i cili tregon në një farë mënyre trendin dhe koston reale të banesave. Në bashkinë Devoll duke parë edhe analizën e mësipërme të moshës së ndërtimeve vërehet se ndërtimet e reja janë të pakëta dhe përgjithsisht është ruajtur struktura e qytetit. Në këtë rast tregu I banesave përbëhet kryesisht nga ndërtime individaule si dhe nga banesa kolektive tip apartament të periudhës socialzmit. Sa I përket çmimeve për m² ato varjojnë nga 225 euro deri në 727 euro me një mesatare prej 420 euro për m².

Tabela 6. Vlera e banesave sipas cimimit në Bashkinë Devoll

Nr	Vendndodhja	Sip në m²	Tipi	Çmimi në Euro	Çmimi m²
1	Bilisht	82	Apartament	47400	578.0
2	Bilisht	110	Apartament	50000	454.5
3	Bilisht	90	Apartament	38000	422.2
4	Bilisht	120	Apartament	55000	458.3
5	Bilisht	117	Apartament	40000	341.9
6	Bilisht	90	Apartament	35000	388.9

7	Bilisht	60	Apartament	23200	386.7
8	Bilisht	90	Apartament	40000	444.4
9	Bilisht	90	Apartament	47400	526.7
10	Bilisht	60	Apartament	13500	225.0
11	Bilisht	110	Vile	80000	727.3
12	Bilisht	150	Vile	60000	400.0
13	Bilisht	170	Vile	67000	394.1
14	Bilisht	120	Vile	35000	291.7
15	Bilisht	100	Vile	40000	400.0

Burimi: Bashkia Devoll dhe MetroPOLIS 2023

2.5 ANALIZA E NEVOJAVE PËR STREHIM SOCIAL DHE TË PËRBALLUESHËM (SHTOJCA 3&4)

Aktualisht, në Shqipëri, sipas ligjit nr. 22/2018, 'Për strehimin social' dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, mund të aplikohen 6 programe strehimi, përkatësisht a) programi i banesave sociale me qira; b) programi për përmirësimin e kushteve të banesave ekzistuese, deri në një ndërtim të ri; c) programi i banesave me kosto të ulët; ç) programi për zhvillimin e zonës me qëllim strehimi; d) programi për krijimin e banesave të përkohshme; dh) programi i banesave të specializuara.

Këto programe gjithashtu edhe ofrimi i ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizaur përbëjnë suportin kryesor në nivel bashkiak mbi politikat e kujdesit social.

Sfidat më të rëndësishme në lidhje me skemën e ndihmës ekonomike jane: kthimi nga një skemë pasive në një skemë aktive nëpërmjet programeve të ri-integrimit dhe alternimit të tyre me skemat e punësimit dhe rritjes se eficencës së saj. Mbulimi më i mirë i familjeve dhe individëve të varfër dhe ekstremisht të varfër është një kusht i domosdoshëm për çdo bashki. Pagesa mujore që përfitojnë familjet e varfëra nga skema e Ndihmës Ekonomike është më e ulët se pagesa e aftësisë së kufizuar. Konkretisht shuma e pagesës mesatare është 3,800 Lek në muaj si ndihmë ekonomike ndërsa ajo e aftësisë së kufizuar është 9,900 Leke në muaj. Për këtë arsye është qartë se numri i përfituesve ka ndryshuar nga një kategori tek tjetra.

Bashkia Devoll nepermjet sektorëve përkatës të përkujdesit shoqëror ofron shërbime sociale në fusha të ndryshme si:

- mbështetje për komunitetin Rom dhe Egjiptian;
- mbështetje për target grupin e personave që janë me aftësi të kufizuar;
- lobim në institucionet qendrore të vendit dhe organizatat jofitimprurese per marrjen e donacioneve ne ndihme te shtresave vulnerabel;
- perkujdesje dhe lobim për të drejtat e barazisë gjinore;
- mbështetje e fëmijëve jetimë
- mbeshtetje per grate e dhunuara

Tabela 7. Numri i aplikanteve dhe përfituesve sipas programit të strehimit social

Nr	Programet e strehimit social	VITET									
		2018		2019		2020		2021		2022	
		A	P	A	P	A	P	A	P	A	P
1	Subvencionimi i qirasë	10	10	5	5	16	16	12	12	8	8

2	**Programë për përshtatjen e përmirësimin e kushteve të objekteve dhe banesave**	33	33	43	43	55	51	160	62	131	73
3	**Programi i banesave me kosto të ulët**							*13			

Burimi: Bashkia Devoll dhe MetroPOLIS 2023

Bashkia Devoll aplikon dy programe të cilat janë:

Subvencionimi i qirasë nga buxheti i shtetit për familjet aplikuese dhe përfituese sipas Ligjit Nr.22/2018 " Për strehimi social" për familjet e pastreha që banojnë me qira në tregun e lirë dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme për të përballuar vetë gjithë vlerën e qirasë. Të gjitha familjet aplikuese dhe përfituse të suvensionimit të qirasë nuk disponojnë banesë në pronësi dhe pasuri të paluajtshme. Pjesa më e madhe e familjeve aplikuese dhe përfituese ne subvensionimin e qirasë janë familje e PAAK, invalid pune, verbëri ,para-tetraplegjik, komunitet rrom-egjiptian, që trajtohen në skemën e një familje që kanë në trung familjar të mitur me status jetimi per rrjellojë të ardhurat për këto familje nuk llogariten. Vetëm një familje aplikuese dhe përfituese është në kategoninë e përfitueseve si emigrant i rikthyer me të ardhura të ulëta.

Përmirësimi (rikonstruksion) i banesave ekzistuese për komunitetet e varfëra dhe të pa favorizuara. Ky projekt ka filluar zbatimin që nga dt.16.06.2017 dhe në vazhdim.

Në Bashkinë Devoll në zbatim të Ligjit Nr.22/2018 " Për strehimi social" janë ne fokus per tu trajtuar me subvencionim qiraje familje te kategorive te meposhteme:

- familje që trajtohen me pagesë paaftësie (me status PAAK,Invalid Pune, Verbëri, Para-Tetraplegjie),
- komunitetet Rom/Egjiptian;
- emigrant i rikthyer me status emigrant;
- viktimat e dhunës në familje (të pajisur me Urdhër Mbrojtje nga Gjykata);
- familja të cilat kanë në certefikatën e tyre familjare, fëmijë me status jetimi;
- nëna të cilat kanë në ngarkim fëmijë të mitur;
- gra kryefamiljare;
- familje këto të cilat nuk kanë mundësi ekonomike për të përballuar vetë vlerën e qirasë në tregun e lirë.

Tek rikonstruksioni i banesave janë shpallur fitues familjet qe i perkasin ketyre shtresave:

- Rom/Egjiptian;
- familjet që trajtohen me pagesë paaftësie për të 4 kategoritë (PAAK,Invalid Pune,Verbëri, Para-tetraplegjie);
- gra kryefamiljare;
- familje që trajtohen me ndihmë ekonomike;
- gra kryefamiljere që kanë në ngarkim fëmijë të mitur;
- kryefamiljarë (burrë/grua) që trajtohen të dy me pensionion pleqërie.

Përsa i përket të dhënave teknike si siperfaqe e objekteve të cilat janë rikonstruktuar varion nga 60-80 m². Nga ana teknike duke pasur parasysh dhe preventivat dëmtimet kanë qënë mbulese çatie, dyer ,dritare dhe tavane. Familjet perfituese jane familje pa te ardhura ose me të ardhura shumë të ulëta të cilat nuk përballojnë dot shtëpi në tregun e lirë, duke përfshirë familje në pozita të pa favorizuar për të përballuar strehimin.

Në këtë program është bërë një identifikim i familjeve potenciale të cila mund te aplikojnë për këtë program bazuar në kushtet e banesave te tyre ku rrezultojnë rreth 135 familje ne nevoje nga te cilat 85 ndodhen ne Bilisht,në fshatrat Vranisht dhe Bitinckë me nga 16 familje secili sidhe 18 familje të tjera në fshatrat Miras, Poncare, Çetë dhe Pilur.

Po ashtu Bashkia Devoll në vitin 2021 ka tentuar të aplikojë dhe programin e banesave me kosto te ulët duket marrë 13 aplikime nën këtë program por pa arritur për ta konkretizuar.


Sipas kategorive sociale të cilat konsiderohet si të avantazhuar për të përfituar nga programet e strehimit social kemi 9 përfituar nga PAK, 1 përftues nga gra kryefamiljare, 2 nga familjet me një prind,2 nga vajza ose nëna, 4 nga jetimët, 14 nga familje rome 4 nga të divorcuar dhe 14 nga kategoritë e tjera.

Aplikimi i programeve te strehimit social në bashki përballet me vështirësi të shumta në kuader të burokracive për aplikuesit apo informacionit te pakët që kanë aplikuesit në kuadër të këtyre programeve gjithashtu mundësitë e pakëta financiare te bashkisë në kuadër të këtij programi.

2.6 Analiza e Trojeve Potenciale për ndërtim

Nga analizat e mësipërme vërehet se bashkia Devoll ka një sërë problemesh në raport me aplikimin e programeve të strehimit social e po ashtu me grupet vulnerabel dhe problematikat që këto komunitete kanë por po ashtu përgjithsisht bashitë me komunitete dhe vendbanime të vogla kanë edhe mundësi më të mira për të zhvilluar prona të cila mund të kthehen dhe të shfrytëzohen.

Figura 8. Zonat potenciale për strehim social



Burimi: Bashkia Devoll dhe MetroPOLIS 2023

Në bashkëpunim me institucionin e bashkisë janë identifikuar disa troje për zhvillime të mundshme të infrastrukturave dhe njësive të akomodimit të nevojave për strehim social të cilat përbëjnë një sipërfaqe prej rreth 5 ha. Zonat në pjesën jug-lindore të qytetit janë zona me troje dhe struktura në pronësi të bashkisë të cilat mund të rehabilitohen dhe të kthehen në struktura të strehimit social për Bashkinë Devoll ndërkohë territori në pjesën veri-lindore të qytetit është një truall në pronësi të bashkisë i cili mund të jetë i përshtatshëm për tu zhvilluar si zonë për ndërtimin e banesave sociale nga aktor si Enti Kombëtar i Banesave apo donatorë të ndryshëm.

VIZIONI, OBJEKTIVAT DHE PROGRAMET

3.1 VIZIONI DHE SFIDAT KRYESORE TË BASHKISË

Të paturit një strehim të përballueshëm është një nevojë jetike dhe e domosdoshme për të siguruar integrimin dhe zhvillimin e një komuniteti, aspekt i cili ka një rëndësi të veçantë për grupet vulnerabël përshkak të kushteve të vështira në të cilat jetojnë. Krijimi i mundësive për zhvillimin e sektorit të strehimit social duke favorizuar një strehim të përballueshëm, me cilësi të lartë, është një aspekt mjaft i rëndësishëm dhe prioritar për bashkitë të cilët kanë detyrim të mundësojnë alternativa të tilla për qytetarët e tyre. Në këtë mënyrë lehtësojnë integrimin e këtyre komuniteteve dhe minimizojnë lëvizjet migratore në territorin e tyre. Plotësimi i nevojave të strehimit do të sjellë përmirësimin direkt të kushteve të banimit dhe rritjen e cilësisë së shëndetit publik, gjithashtu rritje të sigurisë civile dhe ulje të rriskut nga ekspozimi ndaj fatkeqsive natyore. Këto masa do të sjellin po ashtu rritje të cilësisë së shkollimit për fëmijë si dhe reduktim te varfërisë energjitike.

Kushtet e banimit janë të lidhura ngushtësisht me kushtet ekonomike të një familjeje dhe me varferinë relative apo statusin pasuror të saj. Kushtet e përshtatshme të jeteses lidhen gjithashtu edhe me karakteristikat e familjes të tilla si gjinia dhe arsimimi i kryefamiljarit, përbërja e familjes dhe zona gjeografike në të cilën jetojnë. Mungesa e mundesive ekonomike dhe mbipërqendrimi i migruesve të brendshëm ne zonat urbane shoqerohen me perkeqesimin e kushteve te banimit dhe te jeteses, dhe si rrjedhoje me mundesi per krijimin e lagjeve te varfra urbane. Mungesa e ujit dhe kanalizimeve te pershtatshme, strehimi i papershtatshem apo mbipopullimi mund te kene pasoja ne shendet, si edhe ne aftesite e njerezve per te nxjerre te ardhura dhe akumuluar kapital njerezor. Kjo mund te ndikoje vecanerisht ne arritjet arsimore apo ne ndjekjen e shkolles nga femijet. Mosfurnizimi i pershtatshem me energji elektrike mund te ndikoje ne rentabilitetin e investimeve dhe si pasoje ne nje rritje me te vogel ekonomike. Mungesa e arsimit te kryefamiljarit ndikon ne mireqenien e familjes si edhe ne arsimimin e femijeve. Kjo eshte vecanerisht me rendesi ne kontekstin shqiptar, ku vendimet qe merr familja, duke perfshire edhe arsimimin e femijeve, varen shume nga kryetari i familjes. Kryetari i familjes vazhdon ende te mbetet shtylla e familjes, sidomos ne zonat rurale.

Vizioni

Nëpërmjet këtij plani Bashkia e Devollit synon që deri në 2030 të kthehet në një model të ofrimit të strehimit social të qëndrueshëm duke ofruar mundësi të strehimit të përballueshëm, duke zgjeruar gamën e programeve të strehimit social të cilat ofrohen për komunitetin. Devolli angazhohet duke ofruar strehim të sigurtë, të përshtatshëm, të aksesueshëm dhe të përballushëm për grupet vulnerabël, si familjet në ndihmë ekonomike, jetimët, gratë e divorcuara, emigrantët, komunitetin rom dhe egjiptian, policët e rënë në detyrë, çiftet e reja, PAK, etj,

3.2 QËLLIMET DHE PARIMET

1-Në gjetjen e burimeve financiare që ka buxheti i shtetit, fondet e sigurura nga vetë Bashkia si dhe fondet nga burime të tjera (donatoret) duke përcaktuar origjinën e tyre.

2-Përcaktimin e nevojave për strehim duke percaktuar grupet e familjeve sipas të ardhurave dhe gjendjes së tyre sociale.

3- Lidhjen e këtij programi me programe të tjera të Bashkisë Devoll- Numrin e familjeve që do të përfitojnë banesa me kosto të ulët dhe mënyrat e mbashkëpunimit me sektorin privat.

4-Pajisjen e truallit me infrastrukturën për ndërtim banesash, bashkepunim me sektorin privat, etj.

Kjo metodologji konstaton edhe në hartimin dhe metodat për të mbledhur informacionin në mënyrë që ky program të jetë konkret. Ky sigurohet kryesisht brenda Bashkise duke shfrytëzuar edhe burimet jashtë Bashkisë. Gjithashtu në vëmendje është organizimi i punës për informimin e publikut, duke bërë takime të ndryshme me grupe të interesit, sqarime për dokumentacionin, tërheqjen e mendimeve për alternativat në funksion të zgjidhjes së problemit, publikime të projekteve të ndryshme nga ana e Bashkisë sonë. Për të arritur këto qëllime dhe lehtësuar punën për arritjen e qëllimit të strehimit me vendim të kryetarit të Bashkisë **është ngritur një komision konsultativ për strehimin**. Ngritja e këtij komisioni bëhet më shumë i nevojshëm në Bashki me ngarkesë më të madhe të problemit të strehimit duke funksionuar periodikisht gjatë vitit.

3.3 OBJEKTIVAT AFATGJATË DHE PROGRAMET E PROPOZUARA PËR PERIUDHËN 5-VJEÇARE

Janë propozuar tre objektiva strategjikë afatgjatë, zbatimi i të cilëve, sikurse edhe vizioni, synon 10 vitet e ardhshme. Ndërkohë, për çdo objektiv janë vendosur programet për periudhën 5-vjeçare dhe aktivitetet afatgjata të cilat duhet të rivlerësohen në momentin që plani aktual përmbyll periudhën 5-vjeçare 2024-2029.

Objektivi 1: Mundësim i sistemit të qasjes në strehim të përballueshëm për grupet e pafavorizuara në bashki deri në masën 55% për periudhën 2024-2029 me synim rritjen për periudhën afatgjatë.

Ky objektiv përmban disa nënobjektiva të cilët grupohen në: i) përmirësimin e sistemit të informacionit për strehimin social dhe aksesin në të; ii) programet afatmesme dhe afatgjata për strehimin social. Prioritet për bashkinë mbetet plotësimi i nevojave të komunitetit dhe përmbushja e kërkesave për strehim social. Por fillimisht bashkia duhet të përshtasë dhe përditësojë informacionin mbi grupet vulnerabël, duke njohur më mirë nevojat dhe mundësitë e tyrë për strehim.

Nënobjektivi 1.1. Hartëzim i grupeve në nevojë (2024- në vazhdim)

Ky nënobjektiv vjen si përgjigje e sfidës që has vazhdimisht bashkia në pasjen e të dhënave të plota dhe në kohë reale, por edhe grupi i punës gjatë hartimit dhe programimit të këtij plani. Kjo ndodh për shkak të mungesës së të dhënave burimore mbi situatën e strehimit, si dhe klasifikimit të tyre sipas kategorive e programeve nga ku mund të përfitojnë

Për këtë nënobjektiv parashikohen katër masa realizimi i të cilat nisin në vitin 2024 dhe shtrihet përgjatë të gjithë kohës së vlefshmërisë së planit:

- 1.1.1 Organizim i një plani të detajuar pune për evidentimin e grupeve në nevojë sipas Planit të Strehimit.
- 1.1.2 Zhvillimi i vëzhgimeve në terren.
- 1.1.3 Krijimi i bazës gjeografike të të dhënave për grupet në nevojë, me të dhënat nga sistemi online, vëzhgimet në terren dhe vetëdeklarimet e të pastrehëve.
- 1.1.4 Popullim periodik i të dhënave në lidhje me grupet në nevojë në sistemin *online* dhe në bazën e të dhënave (mundësisht GIS / alternativa Excel[1]).

Nënobjektivi 1.2. Ngritja e një sistemi të arritshëm informacioni për aplikim në programet e strehimit social (2024 – në vazhdim)

Ky nënobjektiv synon të rrisë numrin e aplikimeve dhe njohurinë për programet sociale të ofruara, si dhe të promovojë pronarin social si një aktor kyç në skemat e BSQ-së. Realizimi nis në vitin 2024, me qëllim që informacioni të ndihmojë aplikantët në përdorimin e sistemit.

- 1.2.1 Prodhimi e shpërndarja e materialeve informuese mbi mundësitë e përfitimit dhe aplikimit (të printuara dhe në media); përfitimet nga statusi i pronarit social; etj.
- 1.2.2 Takime informuese periodike të bashkisë (të paktën 1 në vit) për grupet në nevojë mbi mundësitë që u ofrohen nga programet.
- 1.2.3 Bashkëpunim i vazhduar me organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që ato të informojnë grupe specifike vulnerabël.

Nënobjektivi 1.3. Ofrim i mundësive të dedikuara për grupe të ndryshme vulnerabël (2024 – 2029 – vazhdim)

Ky nënobjektiv përmbledh kategoritë e identifikuara nga analiza e thelluar, duke synuar të vendosë nga një projekt dhe target për t'i adresuar. Qëllimi themelor është që të adresohen nevojat për strehim për 60 % të aplikuesve në të gjitha programet e strehimit social që do të realizohen në periudhën afatmesme 2024-2029.

- 1.3.1 Mbështetja e familjeve në varfëri ekstreme, duke targetuar kryesisht grupet si familjet e komunitetit Rom dhe Egjiptian, PAK, familjet me NE dhe të moshuarit, nëpërmjet programit të Përmirësimit të Kushteve të Banimit, me rreth 50 familje[2] në periudhën 2024 – 2029.
- 1.3.2 Sigurim Strehimi për minimumi 50% të aplikuesve, të cilët i përkasin shtresave që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe familjeve një prindërore, nëpërmjet programit BSQ (aplikomi për ndërtimin e një BSQ-je dhe subvencionimi i qirasë në treg të lirë) për periudhën 2024 – 2029.
- 1.3.3 Sigurimi i Strehimit nëpërmjet programit të Banesave me Kosto të Ulët (aplikimi për një BKU dhe subvencionimi i interesave të kredisë) për grupe të caktuara si çiftet e reja, familje njëprindërore, familje me shumë anëtarë dhe PAK (vetëm në katin e parë), për minimumi 50% të tyre.
- 1.3.4 Mbështetje për 80% të familjeve me raste të grave të dhunuara ose divorcuara që evidentohen[3], nëpërmjet programit BSQ për periudhën 2024 – 2029, si dhe duke shtuar

[1] Databaza e Excel-it duhet të përmbajë edhe informacionin e pozicionit gjeografik të individëve në nevojë të evidentuar, në formën e koordinatave gjeografike jo vetëm të fshatit, lagjes apo adresës.
[2] Mazhoranca e familjeve në Bashkinë e Devollit janë të pajisura me banesë në pronësinë e tyre por shpesh herë kanë nevojë për përmirësime strukturore.
[3] Aktualisht ka aplikime nga gra të dhunuara por numri eshte shume i vogel, për programet e strehimit social në Bashkinë e Devollit por nga diskutimi me OJF-të lokale raste të tilla janë të shumta në numër.

mundësitë e programit të zhvillimit të zonës dhe banesat e specializuara për periudhën afatgjatë.

Nënobjektivi 1.4. Zbatimi i Programit për Përmirësimin e Kushteve të Banimit (periudha afatgjatë)

- 1.4.1 Vëzhgim i cilësisë së strukturave në zona rurale dhe në komunitetet Rome dhe Egjiptiane dhe aplikim për grant për përshtatje të strukturave në banesa.
- 1.4.2 Pilotim i një projekti për eficiencën energjitike në banesa kolektive.

Nënobjektivi 1.5. Zhvillimi i Zonës për Qëllime Strehimi (periudha afatgjatë)

- 1.5.1 Vlerësim tekniko inxhinierik i strukturave të degraduara ish-industriale/ushtarake apo aseteve publike të degraduara për ripërshtatje për banim.
- 1.5.2 Zhvillim i projekteve për konvertimin e ndërtesave ish-industriale në fond banese.
- 1.5.3 Rehabilitimi infrastrukturor dhe përmirësimi i kushteve të banimit në lagjen e sipërme të qyetit si zonë me përqendrim të lartë të shtresave vulnerabël.

Nënobjektivi 1.6. Strehë të Përkohshme

- 1.6.1 Realizimi i një studimi fizibiliteti për ndërtim të strehëve të përkohshme për familjet e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore dhe për rastet e urgjencës për arsye të tjera.
- 1.6.2 Ndërtimi i banesave të përkohshme të siguruara për familjet e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore (të paktën 5-10 strehë).

Nënobjektivi 1.7. Banesa të specializuara

- 1.7.1 Studim fizibiliteti mbi mundësinë e përballimit të kostos operative të realizimit të Banesave të Specializuara për grupet PAK dhe gratë e dhunuara e viktimat e trafikimit.
- 1.7.2 Realizimi i projektit dhe zbatim i programit në banesat sociale të realizuara.

Objektivi 2: Sigurimi i strehimit të përballueshëm nëpërmjet diversifikimit të pjesëmarrjes në programe të strehimit social për 55% të aplikantëve nga të gjitha grupet në nevojë strehimi

Ky objektiv zbërthen programet e strehimit social që mund të përdoren në Bashkinë Devoll për periudhën 2024-2029. Për çdo program bashkia ka bërë një parashikim si mund të zbatohet, si dhe ka adresuar aktorët e kostot kryesore për të. Prioritet për Bashkinë janë programi i BSQ (Bonusi i strehimit dhe banesa sociale me qera), BKU (në bashkëpunim me EKB) dhe Përmirësimi i Kushteve të Banimit si program i përvitshëm në portofoli n e Bashkisë Devoll, i cili adreson nevojat e disa grupeve vulnerabël. Këto programe bashkia synon t'i zhvillojë me fonde të veta, por kryesisht me mbështetjen e MFE, si dhe duke eksploruar alternativën e PPP-ve, aty ku është e mundur. Suksesi i instrumenteve të partneritetit publik-privat do të përcaktojë edhe zbatimin e programeve të tjera qe momentalisht janë parashikuar për periudhën afatgjatë.

Nënobjektivi 2.1. Zbatimi i programit Banesa Sociale me Qira (BSQ) (2024 – 2029)

- 2.1.1 Ndërtimi i një BSQ-je në Bashkinë e Devoll, me bashkëpunimin e EKB-së
- 2.1.2 Mbështetje me vijim kontrate për familjet që qëndrojnë në BSQ.
- 2.1.3 Subvencionim qiraje për 60 familje deri në 2029.
- 2.1.4 Mbështetje për aplikimin e pronarit social nëpërmjet fushatave të komunikimit të vazhduar.

- 2.1.5 Menaxhim i Banesave Sociale për Qira, përfshirë ato që mund të përfitohen nga Programi i Zhvillimit për Qëllim Strehimin.

Nënobjektivi 2.2. Zbatimi i Programit për Përmirësimin e Kushteve të Banimit

- 2.2.1 Realizimi i studimit dhe projektimit për përmirësimin e kushteve të banimit për familje në nevojë, me fokus të veçantë për të moshuarit, familjet e komunitetit Rom dhe Egjiptian, familjet me ndihmë ekonomike dhe PAK.
- 2.2.2 Përmirësim Kushteve të Banimit për të paktën 150 familje nga grupet e synuara, në 5 vite.

Nënobjektivi 2.3. Banesa me Kosto të Ulët

- 2.3.1 Zbatim i programit të subvencionimit të interesave të kredive për familjet e reja, ose me 1 prind të vetëm (10 familje në vit).
- 2.3.2 Aplikimi për ndërtimin e një BKU me bashkëpunimin e EKB-së. Gjetja e trojeve të përshtatshme për këtë investim dhe impelemtimi për 20 familje në total.

Nënobjektivi 2.4. Banesa e përkohshme dhe të specializuara

- 2.4.1 Zbatimi i programeve te banesave të specializuara dhe i banesave të përkohshme në rehabilitimin e tek ndërtesa e ish-zjarrfikësve e cila sot përdoret si vend strehim për banorët ne varfëri të tejskajshme

Objektivi 3. Forcimi i kapaciteteve vendore dhe të bashkëpunimit vertikal e horizontal në lidhje me strehim social

Ky objektiv duhet të shtrihet përgjatë gjithë periudhës së planit pasi në këtë mënyrë rrit efektivitetin e këtij plani dhe gjithashtu lehtëson dhe informon publikun e gjerë.

- 3.1 Ngritja e Kapaciteteve Lokale për përdorimin e sistemit online të aplikimeve – me mbështetjen e Drejtorisë së Strehimit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë.
- 3.2 Lehtësim i procedurave për aplikuesit e programeve sociale sipas ndryshimeve ligjore në vijim – aspekte që lidhen për shembull me pagesat tek ZRPP për statusin e pronës para regjistrimit si i pastrehë, pagesën e lidhjes së kontratës para noterit për familjet e varfra që përfitojnë nga bonusi i strehimit, përfitimin e disa skemave sociale njëherësh për familje që plotësojnë kriteret, etj.
- 3.3 Harmonizim i Politikave me sektorë të tjerë në funksion të strehimit social, si arsimi, shëndetësia, punësimi, ndihma ekonomike, planifikimi i territorit, mbrojtja civile – përfituesit e programeve të strehimit kanë akses edhe në programe të tjera të mbrojtjes sociale.
- 3.4 Rishikim i PPV-së me fokus sigurimin e orientimeve më favorizuese për strehim social – në paraprirje të studimeve për zbatimin në periudhën afatgjatë të Programit të Zhvillimit të Zonës për Qëllim Strehimi dhe me mundësimin e PPP-ve (Plani I Prokurimeve Publike) për strehim social.
- 3.5 Vlerësim i vazhdueshëm i aseteve bashkiake – në funksion të realizimit në periudhën afatgjatë të Programit të Përmirësimit të Kushteve të Banimit, si dhe atë të Zhvillimit me Qëllim Strehimin, bashkia duhet të përditësojë inventarin e aseteve të saj (truall dhe objekt).
- 3.6 Zgjerim i stafit të njësisë përgjegjëse për strehimin – stafi i dedikuar për fushën e strehimit rritet nga 2 punonjës aktualisht në të paktën 5 punonjës (personel i shtuar si teknik ndërtimi, jurist dhe punonjës social) për 5 vitet në vijim.

3.4 Programi i detajuar

Tabela më poshtë tregon shtrirjen në kohë dhe bën një parashikim të kostove dhe Financimit në harkun kohor prej 5 vitesh. Gjithashtu ajo paraqet treguesit e monitorimit për zbatimin e këtij plani.

Tabela 8. Programi i detajuar

Nënobjektivi	Masa	Kosto e përafërt (ALL)	Burimi i financimit	Tregues	Burimi i të dhënave	Periudha
O1: Mundësim i sistemit të qasjes në strehim të përballueshëm për grupet e pafavorizuara në bashki deri në masën 55% për periudhën 2024-2029 me synim rritjen për periudhën afatgjatë.						
1.1. Hartëzim i grupeve në nevojë	*1.1.1 Organizim i një plani të detajuar pune për evidentimin e grupeve në nevojë sipas Planit të Strehimit.*	500,000	Bashkia Devoll ose Donatorë	Plani i aktiviteteve i përfunduar	Bashkia Devoll	2024-2025
	1.1.2 Zhvillim i vëzhgimeve në terren.	300,000	Bashkia Devoll	Evidenca të vëzhgimeve për çdo kategori	Bashkia Devoll, OJF lokale	2024-2025
	1.1.3 Krijimi i databases gjeografike të grupeve në nevojë, me të dhënat nga sistemi online, vëzhgimet në terren dhe vetëdeklarimet e të pastrehëve.	Pa kosto (Excel) 2,000,000 (GIS)	Bashkia Devoll (Excel, 100%) (GIS, 20%), Donatorë (GIS, 80%)	Sistemi i të dhënave (mundësisht GIS) i populluar	Sektor GIS, Bashkia Devoll	2025-2029
	1.1.4 Popullim periodik i të dhënave në lidhje me grupet në nevojë në systemin online dhe në databazën GIS/Excel.	-	-	Sistemi online i populluar dhe përditësuar	Zyra me një ndalesë, Sektori i Strehimit, Bashkia Devoll	2025-2029 - vazhdim
1.2. Ngritja e një sistemi të arritshëm informacioni për aplikim në programet e strehimit social	*1.2.1 Prodhimi e shpërndarja e materialeve informuese mbi mundësitë e përfitimit dhe aplikimit (të printuara dhe në media); përfitimet nga statusi i pronarit social; etj.*	200,000	Bashkia Devoll, Donatorë (100%)	400 fletushka / postera / broshura / materiale të tjera të printuara, të shpërndara	Bashkia Devoll	2024-2029
	1.2.2 Takime informuese periodike të bashkisë (1 në vit) për grupet në nevojë mbi mundësitë që u ofrohen nga programet.	100,000	Bashkia Devoll, Donatorë	5 takime të kryera me grupet në nevojë	Bashkia Devoll	2024-2029
	1.2.3 Bashkëpunim i vazhduar me organizatat e shoqërisë civile në mënyrë që ato të informojne grupe specifike vulnerabël.	-	Bashkia Devoll	Takime të vazhduara	Bashkia Devoll	2024-2029
1.3. Ofrim i mundësive të dedikuara për grupe të ndryshme vulnerabël	*1.3.1 Mbështetja e familjeve në varfëri ekstreme, duke targetuar kryesisht grupet si familjet e komunitetit Rom dhe Egjiptian, PAK, familjet me NE dhe të moshuarit, nëpërmjet programit të Përmirësimit të Kushteve të Banimit, me rreth 50 familje.*	Sipas programit	Bashkia Devoll OJF	Nr. i familjeve në nevojë ekstreme të përfshira në programe sociale	Bashkia Devoll	2024-2029

	1.3.2 Sigurim Strehimi për minimumi 50% të aplikuesve, të cilët i përkasin shtresave që përfitojnë ndihmë ekonomike dhe familjeve një prindërore, nëpërmjet programit BSQ.	Sipas programit	Ministria e Financës dhe Ekonomisë me bashkëfinancim nga Bashkia Devoll, Donatorë	25 familje me NE dhe njëprindërore	Bashkia Devoll	2024-2029
	1.3.3 Sigurimi i Strehimit nëpërmjet programit të Banesave me Kosto të Ulët për grupe të caktuara si çiftet e reja, familje njëprindërore, familje me shumë anëtarë dhe PAK, për minimumi 50% të tyre.	Sipas programit	Bashkia Devoll EKB	Nr. i familjeve me anëtarë PAK përfituese të programeve të strehimit social	Bashkia Devoll	2024-2029
	1.3.4 Mbështetje për 80% të familjeve me raste të grave të dhunuara ose divorcuara që evidentohen, nëpërmjet programit BSQ si dhe duke shtuar mundësitë e programit të zhvillimit të zonës dhe banesat e specializuara për periudhën afatgjatë.	Sipas programit	Bashkia Devoll Donator OJF	Nr. i familjeve me gra të divorcuara, apo dhunuara, përfituese në programe të strehimit social	Bashkia Devoll	2024-2029
1.4. Zbatimi i Programit për Përmirësimin e Kushteve të Banimit	*1.4.1 Vëzhgim i cilësisë së strukturave në zona rurale dhe i strukturave të banimit të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane dhe aplikim për grant për përshtatje të strukturave në banesa.*	-	Bashkia Devoll	Nr. i ndërtesave në zona rurale dhe i komuniteteve, të vëzhguara dhe kataloguara	Bashkia Devoll	2028-2030
	1.4.2 Pilotim i një projekti për eficiencën energjitike në banesa kolektive.	Sipas projektit	Bashkia Devoll, MFE, Donatorë	Projekt i zbatuar në 1 ndërtesë kolektive në qytet	Bashkia Devoll	2028-2030
1.5. Zhvillimi i Zonës për Qëllime Strehimi	*1.5.1 Vlerësim tekniko inxhinierik i strukturave të degraduara ish-industriale/ushtarake apo aseteve publike të degraduara për ripërshtatje për banim.*	3,000,000	Bashkia Devoll (20%) Donatorë (80%)	10 ndërtesa të vlerësuara	Bashkia Devoll	2025-2027
	1.5.2 Zhvillim i projekteve për konvertimin e ndërtesave ish-industriale në fond banese.	Sipas programit	Bashkia Devoll, Donatorë	Një projekt i finalizuar dhe miratuar	Bashkia Devoll, Drejtoria e Planifikimit dhe Sektori i Strehimit	2029-2031
	1.5.3 Rehabbilitimi infrastrukturor dhe përmirësimi i kushteve të banimit në lagjen e sipërme të qyetit si zonë me përqendrim të lartë të shtresave vulnerabël.	-	PPP – instrumentet finaciare / zhvilluesit	Të paktën 1 njësi strukturore	Bashkia Devoll, Drejtoria e Planifikimit dhe Sektori i Strehimit	2029-2031
1.6. Strehë të Përkohshme	*1.6.1 Realizimi i një studimi fizibiliteti për ndërtim të strehëve të përkohshme për familjet e rrezikuara nga*	1,000,000	Bashkia Devoll	Një studim fizibiliteti për strehët e përkohshme	Bashkia Devoll, Drejtoria e Planifikimit dhe Sektori i	2026-2028

	fatkeqësitë natyrore dhe për rastet e urgjencës për arsye të tjera.				Strehimit, Drejtoria e Emergjencave	
	1.6.2 Ndërtimi i banesave të përkohshme të siguruara për familjet e rrezikuara nga fatkeqësitë natyrore (të paktën 5-10 strehë).	Sipas projektit	Bashkia Devoll, MFE, AKMC, Donatorë	Rreth 10-20 strehë	Bashkia Devoll, MFE, AKMC	2026-2028
1.7. Banesa të specializuara	*1.7.1 Studim fizibiliteti mbi mundësinë e përballimit të kostos operative të realizimit të Banesave të Specializuara për grupet PAK dhe gratë e dhunuara e viktimat e trafikimit.*	1,000,000	Bashkia Devoll, MFE, Donatorë	Një studim fizibiliteti për banesa të specializuara	Bashkia Devoll, Drejtoria e Planifikimit dhe Sektori i Strehimit	2028-2029
	1.7.2 Realizimi i projektit dhe zbatim i programit në banesat sociale të realizuara.	Sipas projektit	Bashkia Devoll, MFE, Donatorë	Nr. i banesave të specializuara	Bashkia Devoll, Drejtoria e Planifikimit dhe Sektori i Strehimit	2029-2031
O2: Sigurimi i strehimit të përballueshëm nëpërmjet diversifikimit të pjesëmarrjes në programe të strehimit social për 60% të aplikantëve nga të gjitha grupet në nevojë strehimi						
2.1 Zbatimi i programit Banesa Sociale me Qira (BSQ)	*2.1.1 Ndërtimi i një BSQ-je të re në Bashkinë e* Devolls*, me bashkëpunimin e EKB-së*	Sipas projektit	*Bashkia* Devoll *(20%, tokë)* MEF (80%, ndërtimi)	Struktura mbrapa komisiariatit të policisë e konvertuar në BSQ	*Bashkia* Devoll	2025-2029
	2.1.2 Mbështetje me vijim kontrate për familjet që qëndrojnë në BSQ.	-	*Bashkia* Devoll	Nr. i familjeve të strehuara në BSQ	*Bashkia* Devoll	2024-2025
	2.1.3 Subvencionim qiraje për 60 familje.	*Sipas programit*	*Bashkia* Devoll	10 familje të strehuara në banesa me qira	*Bashkia* Devoll	*2024-2029*
	2.1.4 Mbështetje për aplikimin e pronarit social nëpërmjet fushatave të komunikimit të vazhduar.	-	*Bashkia* Devoll	Nr. i pronarëve socialë të regjistruar pranë bashkisë	*Bashkia* Devoll	2025-2029
	2.1.5 Menaxhim i Banesave Sociale për Qira, përfshirë ato që mund të përfitohen nga Programi i Zhvillimit për Qëllim Strehimin.	Kosto mirëmbajtjeje	*Bashkia* Devoll	Sipas projektit	*Bashkia* Devoll	2027-2029
2.2 Zbatimi i Programit për Përmirësimin e Kushteve të Banimit	*2.2.1 Realizimi i studimit dhe projektimit për përmirësimin e kushteve të banimit për familje në nevojë, me fokus të veçantë për të moshuarit, familjet e komunitetit Rom dhe Egjiptian, familjet me ndihmë ekonomike dhe PAK.*	3,000,000	MEF, Bashkia Devoll, Donatorë	Një studim dhe projekt për përmirësimin e kushteve të banesave	Bashkia Devoll	2024-2029

	2.2.2 Përmirësim Kushteve të Banimit për të paktën 150 familje nga grupet e synuara, në 5 vite.	Sipas projektit	MEF, Bashkia Devoll, Donatorë	Nr. i banesave të përmirësuara	Bashkia Devoll	2024-2027
2.3. Banesa me Kosto të Ulët	*2.3.1 Zbatim i programit të subvencionimit të interesave të kredive për familjet e reja, ose me 1 prind të vetëm, 10 familje në vit*	Sipas programit	MFE, Bashkia Devoll	Interesat e kredive të subvencionuara për rreth 30 familje në vit	MFE, Bashkia Devoll	2025-2029
	2.3.2 Aplikimi për ndërtimin e një BKU me bashkëpunimin e EKB-së. Gjetja e trojeve të përshtatshme për këtë investim dhe impelemtimi për 20 familje në total.	-	MFE, Bashkia Devoll	Aplikimi / ndërtimi i BKU	MFE, Bashkia Devoll	2025-2029
2.4. Banesa e përkohshme dhe të specializuara	*2.4.1Zbatimi i programeve te banesave të specializuara dhe i banesave të përkohshme në rehabilitimin e tek ndërtesa e ish-zjarrfikësve e cila sot përdoret si vend strehim për banorët ne varfëri të tejskajshme*	–	Bashkia Devoll dhe Donatorë të Ndryshëm	Rehabilitimi I objektit dhe përshtatja për banes ate specializuara dhe të përkohshme	Bashkia Devoll	2027-2029
O3: Forcimi i kapaciteteve vendore dhe të bashkëpunimit vertikal e horizontal në lidhje me strehim social						
3.1 Ngritja e Kapaciteteve Lokale për përdorimin e sistemit online të aplikimeve.		Pa kosto	MFE	Përdorimi i sistemit online në kapacitet të plotë	Bashkia Devoll	2024-2025
3.2 Lehtësim i procedurave për aplikuesit e programeve sociale sipas ndryshimeve ligjore në vijim.		Pa kosto	Bashkia Devoll	Rritje e numrit të aplikimeve	Bashkia Devoll	2024-2029
3.3 Harmonizim i Politikave me sektorë të tjerë në funksion të strehimit social.		Pa kosto	Bashkia Devoll	Procese vendimmarrjeje të koordinuara mes sektorëve	Bashkia Devoll	2024-2029
3.4 Rishikim i PPV me fokus sigurimin e orientimeve më favorizuese për strehim social.		Pa kosto	Bashkia Devoll	PPV e rishikuar e miratuar	Bashkia Devoll	2025-2027
3.5 Vlerësim i vazhdueshëm i aseteve bashkiake.		Kosto shërbimi	Bashkia Devoll, Agjencia Shtetërore e Kadastrës	Inventar i përditësuar i aseteve	Bashkia Devoll	2024-2029
3.6 Zgjerim i stafit të njësisë përgjegjëse për strehimin.		Sipas ligjit	Bashkia Devoll	Të paktën 5 persona total nga 2 aktualisht të punësuar	Bashkia Devoll	2026-2028

MONITORIMI DHE ZBATIMI

Me miratimin e Programit 5-vjeçar të strehimit, Bashkia Devoll do të bëjë përshtatjet respektive në Planin Buxhetor Afatmesëm. Varësisht fazimit të zhvilluar në këtë program, ajo do mobilizojë

kapacitetet njerëzore për vëzhgimet në terren dhe përmirësimin e databases së strehimit. Bashkia, do të angazhohet në informim të komunitetit dhe veçanërisht të pronarëve të mundshëm socialë.

Monitorimi i këtij plani do të kryhet në dy nivele – monitorim i zbatimit të programit 5-vjeçar; si dhe monitorim i situates së strehimit dhe grupeve vulnerabël në nevojë për strehim në bashki. Ky monitorim aktualisht është më i kufizuar, duke qënë se bashkia ende nuk ka ngritur databazën e plotë për strehimin social. Gjithsesi, ky document do shërbejë si bazë për rritjen e kapaciteteve dhe parapërgatitje për vlerësimin dhe programimin për periudhën 2029-2034.

Tabela 9. Monitorimi i situatës së strehimit në Bashki

Nr.	Treguesit	Kush e llogarit treguesin	Vlera bazë Deri 2022	Synimi 2027	Frekuenca e matjes
1	Numri total i aplikuesve	Drejtoria e Strehimit Social	131	-20% (ulet nr. i të pastrehëve)	1 vjeçar
2	Popullimi i sistemit për grumbullimin e të dhënave	Drejtoria e Strehimit Social	70%	100%	1 vjeçar
3	Përqindja e aplikantëve për strehim social që kanë përfituar nga një program strehimi social (përfitues ndaj aplikues)	Drejtoria e Strehimit Social	58.2%	70% të aplikuesve (nr. përfituesish i rritur)	1 vjeçar
4	Numri i familjeve që përfitojnë nga programi i përmirësimit të kushteve të banimit	Drejtoria e Strehimit Social	62 (Mesatare 2020 – 2022)	70	1 vjeçare
5	Numri i familjeve që përfitojnë nga subvencionimi i qirasë	Drejtoria e Strehimit Social	4 (2020-2022)	5 - 10 familje	1 vjeçare
6	Mbështetje për PAK nëpërmjet programeve BSQ	Drejtoria e Strehimit Social Drejtoria e Mbrojtjes dhe e Përfshirjes Sociale	867(total PAK 2022) 9 përf. (2020-2022)	50% e aplikuesve	1 vjeçare
7	Numri i familjeve me gra të dhunuara/ të divorcuara që mbështeten nëpërmjet programeve të strehimit	Drejtoria e Strehimit Social Drejtoria e Mbrojtjes dhe e Përfshirjes Sociale	Nr. i aplikantëve	80%	1 vjeçare
8	Rritja e mbështetjes së komunitetit egjyptian dhe rom për sigurim strehimi të përshtatshëm	Drejtoria e Strehimit Social Drejtoria e Mbrojtjes dhe e Përfshirjes Sociale	Nr. i aplikantëve	50% e aplikantëve	1 vjeçare
9	Rritja e numrit të përfituesve nga subvencionimi i interesave të kredive	Drejtoria e Strehimit Social	0 (2020-2022)	10 familje	1 vjeçare

Tabela 12. Masat për reduktimin e riskut në realizimin e programit

4.1 Risqet e zbatimit

Më poshtë listohen risqet e identifikuara për secilin nënobjektiv, dhe disa masa që duhen marrë apo mund të merren në vijim për të adresuar këto rrisqe. Bashkia parashikon shumë aktivitete që mbështesin njëra tjetrën, në mënyrë që të reduktohet risku në mënyrë domethënëse.

Nënobjektivat	Risku	Masa zbutëse
1.1 Hartëzim i grupeve në nevojë	- Mungesë stafi për të kryer vëzhgimet. - Mungesë fondesh per krijimin e bazës së të dhënave.	- Propozohet si pjesë e këtij program rritja e numrit të stafit në bashki; - Përmes këtij programi, bashkia mund të aplikojë për fonde dhe mbështetje teknike në donatorë të ndryshëm, ndërsa sektori i strehimit duhet të vendosë një pjesë të kostos në programin buxhetor afatmesëm.
1.2 Ngritja e një sistemi të arritshëm informacioni për aplikim ne programet e strehimit social	- Mungesë ekspertize. - Mungesë kapacitetesh financiare.	- Mund të bashkëpunohet me sektorin përgjegjës për komunikimin me publikun.
1.3 Ofrim i mundësive të dedikuara për grupe të ndryshme vulnerabël	- Mungon identifikimi i qartë i këtyre grupeve.	- Për këtë është e nevojshme të kryhen NO 1.1 dhe NO 1.2.
1.4 Zbatimi i Programit për Përmirësimin e Kushteve të Banimit	- Aplikimet për grant nuk miratohen nga MFE. - Nuk gjenden opsione të përshtatshme teknikisht për konvertim në Fond Banese. - Mungesë e fondeve të veta për të kryer vëzhgimet e vlerësimet e banesave/ndërtesave. - Burime njerëzore të kufizura për të realizuar vëzhgimet e strukturave rurale dhe të komuniteteve Rome dhe Egjiptiane.	- Aplikohet Ndërtimi nga e Para, me mbështetjen e MFE; - Rritet stafi i drejtorisë në të paktën 5 punonjës; - Parashikime të aktiviteteve vlerësuese në buxhetin afatmesëm dhe aplikim në programe donatorësh për procesin e vlerësimit.
1.5 Zhvillimi i Zonës për Qëllime Strehimi	- Mungesë e fondeve të veta për të kryer vlerësimin tekniko-inxhinierik dhe financiar. - Mungesë zhvilluesish aktive në qytet për PPP. - Mungesë vullneti për rishikim PPV dhe hartim të PDV-ve me qëllim strehimin social. - Kapacitete të limituara për aplikimin e INK ose TDZH. - Mungesa e koordinimit midis sektorëve në bashki në lidhje me ndërtimet ende të palegalizuara që (do të) preken nga ndërtime infrstrukturore.	- Aplikohet ne EKB, me projekt të kryer / Kalohet në skema PPP; - Kërkohet ndihma e MFE për financim të investimit; - Kërkohet ndihmë nga ekspertizë e jashtme / projekte me donatorë. - Komunikim i vazhduar me drejtorinë e planifikimit dhe sektorin përgjegjës për investimet publike për të vlerësuar kontigjentin e mundshëm të familjeve që mund t'i shtohen listës për strehim social nga zonat informale.
1.6 Strehë të Përkohshme	- Mungesë fondesh për blerje tendash apo ndërtim banesash të përkohshme / të lëvizshme.	- Bashkia duhet të bashkëpunojë me Sektorin EMC dhe me AKMC për të siguruar financim nga qeveria qendrore, apo për të vendosur në dispozicion objekte të tjera publike për strehim.
1.7 Banesa të specializuara	- Mungesë fondesh për të realizuar studimin e fizibilitetit. - Mungesë fondesh vendore e qendrore për të financuar një projekt banesash të specializuara.	- Parashikim në programin buxhetor afatmesëm dhe aplikim për fonde tek donatorët; - Bashkëpunim me organizata të shoqërisë civile për të gjeneruar fonde për studimin dhe për ndërtimin; - Fokusimi i projektit të banesës së specializuar në vetëm disa nga kategoritë që parashikon ligji.
2.1 Zbatimi i programit Banesa Sociale me Qira	- Bashkia nuk ka buxhet të mjaftueshëm për zbatimin e	- Buxheti i alokuar është realist. Nëse ndodh që të mos mbulohet do kërkohet mbështetje

	programit. - Mungesë aplikimesh për pronar social.	MFE; - Do të kryhen fushata më agresive informimi / do të negociohet për benefite më të prekshme nga ana e bashkisë.
2.2 Zbatimi i Programit për Përmirësimin e Kushteve të Banimit	- Mungesë fondesh për realizimin e studimit dhe projektit. - Proces i relaizuar nga të paktën dy sektorë në bashki - strehimi social dhe sektori përgjegjës për investimet. - Mungesë fondesh qendrore për të financuar projektin.	- Parashikim për një pjesë të kostove në programin buxhetor afatmesëm; - Përgatitje e procedurave të bashkëveprimit midis sektorëve/drejtorive në bashki; - Aplikim për fonde tek donatorët; - Konkurrim për grantet e MFE.
2.3 BKU – Subvencionimi i interesave të kredive	- Fonde të kufizuara për subvencionimin veçanërisht në momentin që kryhet nga bashkia.	- Aplikim në projekte me donatorë. - Konkurrim për grantet e MFE.
3.1 Ngritja e Kapaciteteve Lokale për përdorimin e sistemit online të aplikimeve	- Nuk ka staf të përshtatshëm për këtë çështje.	- Kërkohet staf i ri për sektorin, me ekspertizë në menaxhim database.
3.2 Lehtësim i procedurave për aplikuesit e programeve sociale sipas ndryshimeve ligjore në vijim.	- Nuk realizohet dot për shkak të aktorëve që nuk varen nga bashkia.	- Bashkia duhet të lobojë për të mundësuar një proces të lehtësuar.
3.3 Harmonizim i Politikave me sektorë të tjerë në funksion të strehimit social	- Institucionet qendrore dhe drejtoritë e tjera në bashki nuk përgjigjen në mënyrë efikase.	- Bashkia referohet në Ministrinë e Linjës për strehimin në mënyrë që të nxitet bashkëpunimi midis sektorëve në ministritë e linjës; - Komunikim i vazhduar me drejtoritë e tjera të bashkisë.
3.4 Rishikim i PPV me fokus sigurimin e orientimeve më favorizuese për strehim social	- Vonesa në miratim të nismës/ rishikimit. - Mungesa e rishikimeve që adresojnë strehimin social.	- Bashkëpunim me AKPT për të adresuar komente në mënyrë eficiente; - Përgatitje e propozimeve konkrete për rishikim nga drejtoria e shërbimeve sociale me qëllim impaktimin e PPV.
3.5 Vlerësim i vazhdueshëm i aseteve bashkiake	- Mungesa e kapaciteteve për vlerësim. - Mungesa e kushteve financiare për regjistrim.	- Bashkia propozon punësim stafi për të kryer aktivitetet; - Bashkia kërkon ndërmjetësim të qeverisë qëndrore për uljen e tarifave për regjistrim të pronave, rast pas rasti, nëse vërtetohet dobishmëria e tyre për strehim social.

Referencat

Ministria e Zhvillimit Urban, MZHU. (2016). *Strategjia e Strehimit Social 2016-2025.* Tirane: Ministria e Zhvillimit Urban.

Bashkia Devoll. (2018). *Plani për Kujdesin Shoqëror 2019 - 2022* . Devoll: Bashkia Devoll

Bashkia Devoll. (2021). *Plani i Përgjithshëm Vendor i Bashkisë Devoll, Plani i Zhvillimit.* Devoll: Bashkia Devoll.

Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (SOROS). (2014). *Census 2014 Banesat dhe Popullata Rome në Shqipëri.* Tiranë: Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (SOROS).

Fondacionit Shoqëria e Hapurpër për Shqipërinë (OSFA); Leviz Albania; Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim. (2022, Gusht 30). *PortaVendore*. Retrieved from PortaVendore.al: https://portavendore.al/

INSTAT. (2011). *CENSUSI I POPULLSISË DHE BANESAVE 2011* . Tiranë: INSTAT.

INSTAT. (2020). *Vjetari Rajonal Statistikor, 2020.* Tiranë: INSTAT.

INSTAT. (n.d.). *INSTAT-ëeb Atlas*. Retrieved from INSTAT-ëeb Atlas: https://instatgis.gov.al/#!/l/prefectures/population/prefpop1

Ministria e Zhvillimit Urban. (2017). *Vlerësim i nevojave për investime në vendbanimet e komuniteteve Rome dhe Egjiptiane me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës së tyre.* Tirana: UNDP.

Portali i Financave Vendore. (2022). *Profili i Bashkisë Devoll.* ëë.financatvendore.al.

Anekset

Aneksi 1 Analiza Plotësuese e Strehimit Social Bashkia Devoll

Aneksi 2 Minuta Takime Bashkia Devoll